



## REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

---

KA.nr.395/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “FIZIO MED” SH.P.K., me seli në Ferizaj, kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, Inspektorati Shëndetësorë, me seli në Prishtinë Rr. “Zagrebit” pn. për shkak të anulimit të Vendimit Nr. 10/K-43-19 të datës 03.01.2020, me numër të protokollit nr. 05-4 , i nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, Inspektorati Shëndetësorë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë publik më datë 13.02.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit sipas autorizimit A.Z.-Drejtore i Fizio Med, ndërsa në mungesë të përfaqësuesit me autorizim të palës së paditur, ndërsa më datë 11.03.2024, merr këtë:

### A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “FIZIO MED” SH.P.K., me seli në Ferizaj, kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, Inspektorati Shëndetësorë, me seli në Prishtinë.
- II. **ANULOHET** Vendimit Nr. 10/K-43-19 të datës 03.01.2020, me numër të protokollit nr. 05-4 , i nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, Inspektorati Shëndetësorë, si i kundërligjshëm.
- III. Ky aktgjykim e zëvendëson aktin e anuluar.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

## Historiku procedural

1. Më datë 30.01.2020, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, paditësi “FIZIO MED” SH.P.K., me seli në Ferizaj, ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.nr. 238/2020, kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, Inspektorati Shëndetësorë, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit Nr. 10/K-43-19 të datës 03.01.2020, me numër të protokollit nr. 05-4 , i nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, Inspektorati Shëndetësorë, me propozim që gjykata të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit FIZIO MED” SH.P.K. dhe të anuloj vendimin Nr. 10/K-43-19 të datës 03.01.2020, me numër të protokollit nr. 05-4, i të paditurës nga Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, Inspektorati Shëndetësorë, si i kundërligjshëm.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA nr. 259/22.
3. Gjykata mbajti seancë përgatitore më datë 13.02.2024, ndërsa në të njëjtën ditë mbajti seancë të shqyrtimit kryesor publik, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit A.Z.-Drejtor i Fizio Med, ndërsa në mungesë përfaqësuesit të palës së paditur sipas autorizimit nga avokatura shtetërore, konform nenit 41 të LKA-së gjykata ka konstatuar se ka pranuar një parashtrësë të datës 31.01.2024 nga e paditura për deklaram për seancë duke propozuar që seanca të mbahet pa prezencën e palës së paditur.

## Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në padi, në pretendimet e dhëna gjatë shqyrtimit kryesorë si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, e paditura në vendimin e Kryeinspektorit Shëndetësorë Nr. 10/K-3-19 i datës 03.01.2020, thjesht ka vendosur lidhur me ankesën e paditëses së datës 24.04.2017 duke i injoruar faktin se Gjykata me aktgjykimin A.nr. 1000/17 të datës 23.10.2019 kishte anuluar edhet vendimin e shkallës së parë vendimin Nr. 10/R-61-17 të datës 13.04.2017, të nxjerr nga

Inspektorati Shëndetësor i Kosovës, Për më tepër në pikën II të vendimit të saj e paditura ka vendosur që të mbetet në fuqi vendimi me numër të protokollit 05-2768 ik datës 13.04.2017, duke vepruar në kundërshtim të plotë me rregullat e procedurës me që Gjykata me Aktgjykim A.nr. 1000/17 të datës 23.10.2019 kishte anuluar vendimin Nr. 10/R-86-17 të datës 16.05.2017 të Ministrisë së Shëndetësisë si vendim i shkallës së dytë dhe vendimin Nr. 10/R-61-17 të datës 13.04.2017 me nr. prot. 05-2768 si vendim i shkallës së parë, duke ke kthyer çështjen në rivendosje dhe rishqyrtim tek organi i shkallës së parë dhe jo si ka bërë e paditura duke vendos si organ i shkallës së dytë dhe duke e mbajtur në fuqi Vendimin e Inspektoratit Shëndetësor me numër të protokollit 05-2768 të datës 13.04.2017, të cilin e kishte anuluar gjykata.

5. Ka deklaruar se paditësja ka aplikuar pran Ministrisë së Shëndetësisë për hapjen e ambulancës të Terapisë Fizikale në Kaçanik, ndërsa paditësja është bashkëpronare në shoqërinë tregtare “Fizio Med” SH.P.K. dhe ambulancën e Terapisë Fizikale e ka hapur në kuadër të njësisë/degës së biznesit të saj të regjistruar në Ferizaj. Ministria e Shëndetësisë, pas plotësimit të kushteve ligjore, i ka lëshuar ankueses licencën Nr. 62/2016 më datë 28.01.2016 e cila ka qenë e vlefshme deri më 27.01.2021 për Ambulancën e Terapisë Fizikale në Kaçanik. Pasi që numri i pacientëve ka qenë i vogël duke e pamundësuar që me të ardhurat e vitit të mbulohen shpenzimet e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë, në shkurt të vitit 2017 në selinë e shoqërisë tregtare “FIZIO MED”, SH.P.K., të hapë edhe një ambulancë të Terapisë Fizikale. Paditësja ka menduar se Licenca Nr. 62/2016 e datës 28.01.2016 për Ambulancën e Terapisë Fizikale në Kaçanik, mund të përdoret dhe e mbulon veprimtarinë që ajo planifikonte ta hapë në Ferizaj, ku edhe e kishte selinë të regjistruar biznesi i saj “FIZIO MED”SH.P.K. Pasi që është marrë vendimi nga Inspektorët Shëndetësorë se nuk mundet të zhvillohet veprimtaria në Ferizaj në bazë të licencës së e poseduar për në Kaçanik, edhe pse në procesverbalin e datës 01.03.2017 nuk i është dhënë ndonjë afat brenda të cilit do të eliminohejshin të metat e konstatuara siç e kërkon dispozita e nenit 7.7 e Ligjit Nr. 02/L-38 për Inspektoratin Shëndetësorë), paditësja ka aplikuar në Ministrinë e Shëndetësisë për Licencë dhe Ministria ka lëshuar Licencën nr. 58/2017 të datës 07.04.2017 e vlefshme deri më 06.04.2022 për Ambulancë të Terapisë Fizikale në Ferizaj.

6. Për më tepër ka deklaruar se gjoba e shqiptuar me vendimin e Inspektoratit Shëndetësorë të Kosovës Nr. 10/R-61-17 me nr. prot. 05-2768 të datës 13.04.2017, dhe vendimi i Kryeinspektorit Shëndetësorë Nr. 10/R-86-17 i datës 16.05.2017 me nr. prot. 05-2768/3 të datës 16.05.2017 dhe nga kjo shihet se në kohën e shqiptimit ët gjobës dhe kohën e vendosjes së ankesës nga organi i shkallës së dytë paditësja ka qenë e pajisur me licencë e cila mban datën 07.04.2017. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet padia e paditësit dhe të anulohet vendimi i Kryeinspektorit Shëndetësorë Nr. 10/K-43-19 i datës 03.01.2020 me nr. prot. 05-4, si i kundërligjshëm.

#### Kundërshtimet e të paditurës

7. Përfaqësuesi i të paditurës, në përgjigje në padi, ka deklaruar se e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, ngase vendimi i atakuar është marr konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe të lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm.

#### Provat e administruara

8. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Çertifikata e Biznesit për Fizio Med ShPK me nr. unik identifikues 810198045, Vendim me nr.10/K-43-19 i datës 03.01.2020, Licenca për Fizio Med me nr.62/2016, Procesverbal i Inspektoratit Shëndetësor me nr.003466 me datë 01.03.2017, Faturë për pagesë të gjobës në shumë prej 2000 euro, Licencë për Fizio Med më nr.58/2017, Vendim i Inspektoratit Shëndetësor me nr. prot:052768/3 i datës 16.05.2017, Vendim me nr.052768 datë 13.04.2017, Vendim me nr.052866 me datë 18.04.2017, Dokumentacioni shëndetësor i përfaqësuesit të paditësit.

9. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenit 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, deklaratimet e përfaqësuesit të paditësit në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.
10. Sipas Certifikatës së Biznesit “FIZIO MED” SH.P.K., më datë 17.12.2015 është i regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Ferizaj, me numër unik identifikuar 810198045.
11. Ministria e Shëndetësisë ka lëshuar licencë me nr. 62/2016, për biznesin “FIZIO MED”, Ambulancë e Terapisë Fizikale me seli në Kaçanik, nga data 28.01.2016 deri më datë 27.01.2021.
12. Me datë 01.03.2017 Inspektorati Shëndetësor ka kryer inspektim në “FIZIO MED” SH.P.K., Ambulanca e Fizioterapisë Fizikale, me seli në Ferizaj. Në Procesverbal të ISH me nr.003466 nga inspektorët është konstatuar se sipas infermierës Znj. Sh.B. “Fizio Med” SH.P.K., kanë aplikuar për licencim në Ministrinë e Shëndetësisë dhe konstatohet se mbetet të verifikohet në departamentin për licencim pran Ministrisë së Shëndetësisë.
13. “FIZIO MED”, SH.P.K. Ambulanca e Terapisë Fiskale, me seli në Ferizaj është pajisur me Licencë nr.58/2017, nga Ministria e Shëndetësisë nga data 07.04.2017 deri më datë 06.04.2022. Sipas Vendim me nr.052866 me datë 13.04.2017, me të cilin është aprovuar kërkesën e aplikuesit për licencim V.R.Z. pronare e “FIZIO MED” SH.P.K., Ambulanca e Fizioterapisë Fizikale, me seli në Ferizaj.
14. Ministria e Shëndetësisë me Vendim me nr.052768 datë 13.04.2017, Znj V.R.Z., Pronare e “FIZIO-MED”, SH.P.K., i ka shqiptuar gjobe në vlerë prej 2,000.00 euro për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore për mos licencim të subjektit shëndetësor privat në Ministrinë e Shëndetësisë, me arsyetim se gjatë inspektimit nga Inspektorati Shëndetësorë i Republikës së Kosovës më datë 01.03.2017 u konstatua se në këtë subjekt shëndetësor ofrohej shërbim shëndetësor në lëmin e Fizioterapisë në kohën e

inspektimit një pacient ndodhej brenda duke marr shërbim shëndetësor, duke u bazuar nga prova e inspektuar fletore ku regjistroheshin pacientët që kanë marrë shërbim shëndetësor, figuron se në këtë subjekt shëndetësor ofrohet shërbim prej qershorit të vitit 2016. Ndaj këtij vendimi paditësi “FIZIO MED”, SH.P.K. ka parashtruar ankesë.

15. Inspektoratit Shëndetësor me Vendim me nr. prot:052768/3 i datës 16.05.2017, nr. 10/R-86-17, e ka refuzuar ankesën me numër 05-2768 e parashtruar nga “FIZIO MED”, SH.P.K., me arsyetim se duke u bazuar në konstatimet e ekipit inspektues, ankesa e parashtruar nuk përmban fakte të reja që e kundërshtojnë apo argumentojnë si të pa bazë vendimin e shkallës së parë, të lëshuar nga Inspektorati Shëndetësor, më datë 13.04.2017 me nr. prot. 05-2768.
  
16. Me Vendim me nr.10/K-43-19 i datës 03.01.2020, Ministria e Shëndetësisë-Inspektorati Shëndetësorë ka refuzuar si të pa bazuar ankesën me nr. prot. 05-2768/2 e datës 24.04.2017 të ankuesit tani paditësit “FIZIOMED” SH.P..K, duke e lënë në fuqi vendimin e Inspektoratit Shëndetësorë, me nr. Prot/ 05-2768 i datës 13.04.2017, me arsyetim se Kryeinspektori Shëndetësor konstatoi se në Raportin e Inspektimit me nr. Prot. 05-2767 i datës 13.04.2017, inspektori i rastit kishte sqaruar se në këtë subjekt privat shëndetësor ofrohej shërbim shëndetësor në fushën e fizioterapisë dhe në kohën e inspektimit një pacient ndodhej brenda hapësirave, është hasur një fletore ku regjistroheshin pacientët që kanë marrë shërbim shëndetësor duke figuruar se në këtë subjekt ofrohej shërbim shëndetësor prej qershorit të vitit 2016. Pas verifikimit se nëse pronarja e “FIZIO MED” SH.P.K., kishte aplikuar për licencim pran Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), u vërtetuar se Znj. V.R.Z. pronare e “FIZIO MED” SH.P.K., nuk kishte aplikuar për licencim, duke vepruar në kundërshtim me nenin 42 par. 1 të Ligjit për Shëndetësi Nr. 04/L-125 i cili përcakton se të gjitha institucionet shëndetësore mund të fillojnë punën vetëm pas licencimit nga Ministria ose nga organi i autorizuar prej saj. Vendimi për shqiptimin e dënimit është marrë në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse Kryeinspektori Shëndetësorë. Pagesë e gjobës në shumë prej 2000 euro është realizuar me datë 13.04.2017.

## Vlerësimi i gjykatës

17. Pas vlerësimit të pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në seancë, deklarimeve në padi nga paditësi, si dhe në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 43 dhe 44 të LKA-së, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.
18. Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 11 par. 3 të Ligjit Nr. 02/L-38 për Inspektoratin Shëndetësor i cili përcakton: *Kundër vendimit përfundimtar të Inspektoratit shëndetësor mund të ngritët kontest administrative në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh*, dhe nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se: *Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.*
19. Gjykata vlerëson se, me vendimin e kundërshtuar Nr.10/K-43-19 i datës 03.01.2020, Ministria e Shëndetësisë Inspektorati Shëndetësorë ka refuzuar si të pa bazuar ankesën me nr. prot. 05-2768/2 e datës 24.04.2017 të ankuesit tani paditësit “FIZIOMED” SH.P..K, duke e lënë në fuqi vendimin e Inspektoratit Shëndetësorë, me nr. Prot/ 05-2768 i datës 13.04.2017, me arsyetim se Kryeinspektori Shëndetësor sipas Raportit të Inspektimit me nr. Prot. 05-2767 i datës 13.04.2017, në këtë subjekt privat shëndetësor ofrohej shërbim shëndetësor në fushën e fizioterapisë dhe në kohën e inspektimit një pacient ndodhej brenda hapësirave, është hasur një fletore ku regjistroheshin pacientët që kanë marrë shërbim shëndetësor duke figuruar se në këtë subjekt ofrohej shërbim shëndetësor prej qershorit të vitit 2016. Pas verifikimit se nëse pronarja e “FIZIO MED” SH.P.K., kishte aplikuar për licencim pran Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), u vërtetuar se Znj. V.R.Z. pronare e “FIZIO MED” SH.P.K., e njejta nuk kishte aplikuar për licencim, në kundërshtim me nenin 42 par. 1 të Ligjit për Shëndetësi Nr. 04/L-125 i cili përcakton se të gjitha institucionet shëndetësore mund të fillojnë punën vetëm pas licencimit nga Ministria ose nga organi i autorizuar prej saj.

20. Gjykata vlerëson se konstatimet në Vendimin e kundërshtuar Nr.10/K-43-19 i datës 03.01.2020 nga Ministria e Shëndetësisë Inspektorati Shëndetësorë janë në kundërshtim me provat e administruara, përkatësisht janë në kundërshtime me konstatimet ne Procesverbal me nr. 003466 i datës 01.03.2017, ku me rastin e inspektimit në ordinancën “FIZIO MED”, për terapi fizikale me adresë në Rr. “ Naim Frashëri” në Ferizaj, në prani të Infermierës Sh.B., nuk ishte konstatuar asnjë pacient prezent dhe asnjë fletore ku regjistroheshin pacientët që kanë marrë shërbim shëndetësor, përveç konstatimit se paditësi “FIZIO MED” SH.P.K., ka aplikuar për licencim në Ministrinë e Shëndetësisë dhe kjo mbetet të verifikohet në Departamentin për Licencim dhe Akreditim në Ministrinë e Shëndetësisë. Po ashtu paditëses se i është ndaluar ushtrimi i veprimtarisë së SPSH “FIZIO MED”, deri në licencim.
21. Ligjit Nr. 02/L-28 për Inspektoratin Shëndetësor Neni 7 7.1. përcakton: *Inspektorët shëndetësorë kanë autorizimin për qasje të papenguar në inspektimin e implementimit të akteve normative të institucioneve shëndetësore, sipas paragrafit 7. Kërkon të përmirësohen dhe mënjanoohen pengesat në afat të caktuar të cilat mund të paraqesin shkelje të dispozitave ligjore.*
22. Gjykata vlerëson se në pajtim me Ligjin nr. 04/l-125 për Shëndetësi, Neni 42 Licencimi dhe Akreditimi ku përcaktohet se *Të gjitha institucionet shëndetësore mund të fillojnë punën vetëm pas licencimit nga Ministria ose nga organi i autorizuar prej saj, në pajtim me aktin nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria, që përcakton kushtet specifike për punë sa i përket: hapësirës, kuadrit profesional, dhe pajisjeve medicinale,* asnjë institucion shëndetësor nuk mund të fillojnë punën para licencimit nga Ministria. Megjithatë, pavarësisht se inspektorët shëndetësor sipas procesverbalit të datës 01.03.2017 paditëses nuk i ka caktuar ndonjë afat, brenda të cili te njëjta do të i eliminonte pa rregullsitë e konstatuara me raportin e datës 01.03.2017, sepse e njëjta as që do të duhet të hapej pa licencë, por në procesverbal të datës 01.03.2017, kur është kryer inspektimit nuk është konstatuar asnjë pacient apo të se janë gjetur të dhëna të pacientëve, nga rezulton se përmbajtja e Raportit e inspektimit me numër të protokollit 05-2767 i datës 13.04.2017, e rrjedhimisht edhe vendimi i kundërshtua



janë në kundërshtim me gjendjen faktike të konstatuar me rastin e inspektimi të kryer më datë 01.03.2017.

23. Gjykata e vlerësoj se te bazuar pretendimin e paditësit se ordianca ka qenë duke u përgatitur për hapje sepse e njëjta kishte aplikuar për licence dhe licenca me Nr. 58/2017 i është lëshuar paditëses si themeluese e “FIZIO MED”, Ambulancë e Terapisë Fizikale, me adresë në Rr. “Naim Frashëri” Ferizaj nga data 07.04.2017, e vlefshme deri më datë 06.04.2022. Ndërsa vendimi për shqiptimin e gjobës është marrë më datë 13.04.2017, dhe vendimi i atakuar është marrë më datë 16.05.2017, nga kjo rezulton se paditësja në kohën kur i është shqiptuar gjoba e njëjta ka qenë e pajisur më Licencë.
24. Gjykata vlerëson se e paditura nuk i ka eliminuar shkeljet ligjore tw konstatuara me Aktgjykim A.nr. 1000/17 të datës 23.10.2019 me cilin ishte anuluar vendimin Nr. 10/R-86-17 të datës 16.05.2017 të Ministrisë së Shëndetësisë si vendim i shkallës së dytë dhe vendimin Nr. 10/R-61-17 të datës 13.04.2017 me nr. prot. 05-2768 si vendim i shkallës së parë, dhe çështja ishte kthyer në rivendosje dhe rishqyrtim.
25. Prandaj gjykata vlerëson se vendimi Nr. 10/K-43-19 të datës 03.01.2020, me numër të protokollit nr. 05-4 , i nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë, Inspektorati Shëndetësorë, është në kundërshtim me gjendjen e vërtetuar faktike dhe bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Vendimi për shpenzimet procedurale u more në bazë të nenit 63 të LKA-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.395/22, datë 13.03.2024

Gjyqtarja  
Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.